



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 2857/1 Prot.

Tiranë, më 30.04. 2024

URDHËR

NR. 192, DATË 30.04.2024

“PËR  
CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT DHE MBARIMIT TË VITIT AKADEMIK 2024-  
2025, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “i”, të pikës 2, të nenit 7 dhe të pikës 1, të nenit 87, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Fillimin e vitit akademik 2024-2025, në institucionet e arsimit të lartë, në datën 7 tetor 2024 dhe mbarimin e tij në datën 26 shtator 2025.
2. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në të gjithë ndërmarrjet “Trajtimi i studentit”, sh.a, listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

*Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

MINISTËR

OGERTA MANASTIRLIU

